

SENATI AKADEMIK

Nr. 1157Prot

Tiranë, më 27.12.2017

VENDIM

"Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimit, në Sh.P.A.L Universiteti Metropolitan Tirana, për vitin akademik 2018-2019"

Bazuar në Ligjin nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 25 pika 8, neni 38, pika 1/a dhe 3, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, neni 74 pika 2, neni 135, Senati Akademik në mbledhjen e datës 27 dhjetor 2017, mbi diskutimet e zhvilluara sipas rendit të ditës, vendosi:

I. Kriteret e pranimit për studentët e ciklit të parë të studimit, për vitin akademik 2018-2019, të jenë si më poshtë vijon:

Për shkollat e mesme të përgjithshme (gjimnaze) dhe për shkollat e mesme të profilizuara (profili teknike/ekonomike)

1. Nota mesatare e shkollës së mesme apo të profilizuar (nota mesatare e thjeshtë), për të gjitha vitet, përfshirë provimet e maturës shtetërore, të jetë në masën 60%.
2. Nota mesatare e gruplëndëve të përcaktuara për cdo program studimi të ciklit të parë, të jetë në masën 40% (sipas tabelës bashkëlidhur).

II. Ky vendim t'i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

III. Ky vendim hyn në fuqi për vitin akademik 2018-2019.

Kryetar i Senatit Akademik

Prof. Dr. Agim Selenica




ShPAL “Universiteti Metropolitan Tirana”
Ndarja e përqindjes sipas gruplëndëve
Viti akademik 2018-2019

Për kandidatët që vijnë nga shkolla e mesme (gjimnaze) dhe shkolla të mesme të profilizuara tekniko-ekonomike

| Nr | Program studimi | Nota mesatare e gruplëndëve % | Lëndët e gruplëndëve | % për cdo lëndë |
|-----------|--------------------------------|--------------------------------------|-----------------------------|------------------------|
| 1 | Inxhinieri Kompjuterike | 40% | Matematikë | 20 |
| | | | Informatikë | 20 |
| 2 | Inxhinieri Ndërtimi | 40% | Matematikë | 20 |
| | | | Fizikë | 20 |
| 3 | Arkitekturë | 40% | Matematikë | 20 |
| | | | Histori Arti | 20 |
| 4 | Administrim Biznesi | 40% | Matematikë | 20 |
| | | | Ekonomi | 20 |
| 5 | Financë | 40% | Matematikë | 20 |
| | | | Ekonomi | 20 |
| 6 | Informatikë Ekonomike | 40% | Matematikë | 20 |
| | | | Ekonomi | 20 |

Pë r programin e studimit me karakter profesional, në “Dizajn Grafik” kriteret e pranimit janë sipas parashikimit të ligjit.